



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE

Dhjetor 2019

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Dhjetor 2019

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2019
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2019 arriti në 107.1 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Dhjetor 2019 ishte 1.15 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Dhjetor 2019 ishte 109.94 lekë për dollarë dhe 122.17 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Dhjetor 2019 shënuan kuotën 0.43 për qind për ato 12-mujore; 0.41 për qind për depozitat 6-mujore; 0.17 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.72 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.82 për qind për huatë 12-mujore dhe 6.34 për qind për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.318.369 milionë lekë në muajin Dhjetor, duke shënuar një rritje prej rreth 4.3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2019-ës rezultoi me rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 109.7 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Dhjetor 2019 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth -31.5 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej -32.9 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2019, arritën në rreth 460.349 miliardë lekë ose afërsisht 95% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 491.897 miliardë lekë ose rreth 95% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Dhjetor 2019 ishte +1.15%. Ndërsa, një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +1.8%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Dhjetor 2019 shënoi rritje prej 0.8 për qind krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa për muajin Nëntor dhe muajin paraardhës Tetor 2019, indeksi pësoi rënie me 0.2 për qind përkatësisht, krahasuar me muajin parardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Dhjetor 2018 shënoi rritje prej 1.1 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Dhjetor 2018, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2.6%, pasuar nga grupet “Argëtim e kulturë” me 2.2%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1.2%, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0.6%, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0.2% etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, çmimet e grupit “Shëndeti” u ulën me 0.4%, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0.2%.



Ndryshimi mujor i indeksit është 0.8%. Krahasuar me muajin Nëntor 2019, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rriten me 2.0%, pasuar nga grupet “Transporti” me 0.6%, “Argëtim dhe kulturë”, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me nga 0.2% secili, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” dhe “Veshje dhe këpucë” me 0.1% secili. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” u ulën me 0.2%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2018	1.7	2.1	2.0	2.1	2.1	2.4	2.3	2.2	2.1	1.9	1.8	1.8
2019	1.9	1.7	1.1	1.4	1.5	1.3	1.5	1.5	1.3	1.3	1.4	1.2


Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Dhjetor 2019, arriti në 122.17 lekë/euro, duke pësuar rënie në vlerë me 0.51 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Dhjetor, një euro u këmbye me 121.77 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Dhjetor 2019 arriti në 109.94 lekë/dollarë duke pësuar rënie në vlerë me 1.01 për qind kundrejt muajit Nëntor 2019. Në fund të muajit Dhjetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 108.64 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Dhjetor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 1.04 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 1.39 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Dhjetor 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një rritje mesatare rreth 0.9 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Dhjetor 2019, normat e interesit të depozitave me afat 1, 12 dhe 6 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.72, 0.43 dhe 0.41 për qind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 3 mujore që arritën kuotën 0.17 për qind.


Normat e interesit të depozitave 1 dhe 3 mujore kanë shënuar rritje mujore prej përkatësisht 0.07 dhe 0.04 pikë përqindje respektivisht, ndërsa normat e interesit të depozitave 6 dhe 12 mujore kanë pësuar rënie mujore me 0.17 dhe 0.10 pikë përqindje përkatësisht.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 3, 6 dhe 12 mujore, kanë pësuar rënie vjetore prej 0.13, 0.15 dhe 0.32 pikë përqindje përkatësisht, ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 1 mujore kanë shënuar rritje me 0.10 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit Dhjetor 2019 arritën përkatësisht kuotën prej 6.34 dhe 6.82 për qind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 mujore kanë pësuar rënie mujore prej 0.68 pikë përqindje, ndërsa ato 12 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.39 pikë përqindje. Gjithashtu, duke e krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 mujore kanë pësuar rënie vjetore prej 1.82 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje vjetore me 0.48 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Dhjetor 2019 arritën nivelin 1.69 për qind duke shënuar kështu rënie mujore prej 0.16 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.26 pikë përqindje.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë


4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të vitit 2019 rezultoi pozitiv dhe në zgjerim të mjeteve valutore, me rreth 110 milionë euro. Tremujori i tretë i 2019-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 161 milionë euro. Në terma vjetorë, deficitin korrent u zgjerua me rreth 10%. Deficiti tregtar (mallra dhe shërbime) u zgjerua me rreth 5%, në nivelin 377 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 141 milionë euro, në zgjerim me rreth 18 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë. Fluksi hyrës neto në llogarinë financiare vlerësohet në 125 milionë euro dhe mbulon në masën 78% deficitin korrent.

Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.


Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve korrente shënon 3,630 milionë euro, në rritje me rreth 9% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në 161 milionë euro, rreth 10% më i lartë krahasuar me një vit më parë. Thellimi i deficitit korrent, reflekton zgjerimin e deficitit tregtar në mallra dhe balancës negative të të ardhurave parësore nga investimet. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e dytë 2019 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -824.6 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 447.7 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -39.9 milionë euro,
- (iv) transfertat neto me 255.6 milionë euro.



Bilanci i Pagesave per T3 - 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë



Llogaria Korente per T3 - 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Dhjetor 2019, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 8.750 milionë lekë krahasuar me muajin Dhjetor të vitit 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankës paradepozituese me 19.178 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 3.467 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 5.244 milionë lekë e bankës qendrore.




Fig-7

Ecuria e M.V.N. të sistemit në Dhjetor '18 - Dhjetor '19

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.318.369 milionë lekë në muajin Dhjetor 2019, duke shënuar rritje prej rreth 54.441 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 4.3 për qind.

Gjithashtu në muajin Dhjetor 2019, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 15.388 milionë lekë ose 1.2 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.




Fig-8

Agregati M3 Dhjetor '18 - Dhjetor '19



Burimi: Banka e Shqipërisë

6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Dhjetor 2019 arriti në rreth 570.553 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 37.924 milionë lekë, ose rritje me rreth 7.12 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (52.3%) dhe monedhave të huaja (47.7%).

Gjatë muajit Dhjetor 2019, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 58.9 për qind ose 335.885 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.42 për qind ose 196.370 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arrijnë respektivisht 4.24 dhe 2.38 për qind apo 24.182 dhe 13.555 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Dhjetor 2019, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 71.54 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.33 për qind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.03 për qind dhe rreth 2.09 për qind.



7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 291.404 milionë lekë në fund të muajit Dhjetor 2019. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Dhjetor 2019 ka shënuar rritje mujore prej 0.11 për qind, si dhe rritje vjetore prej 0.32 për qind, duke arritur nivelin 22.1 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.18 për qind dhe rritje vjetore prej 0.53 për qind, duke shënuar nivelin 28.4 për qind.


Fig-11



Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Dhjetor 2019, kanë shënuar rritje vjetore prej 28.007 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.3 për qind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Dhjetor 2019 shënuan rritje prej 10.311 milionë lekë në krahasim me muajin Dhjetor 2018. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.6 për qind të tyre.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3
Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Dhjetor 2019, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.6 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.9 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.3 për qind dhe rreth 16.7 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.4 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 835.588 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (153.398 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (20.345 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (15.840 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.792 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Dhjetor 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Dhjetor 2019, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.026.965 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 10.568 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 38.319 milionë lekë.


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Dhjetor 2019 janë mbledhur rreth 460.349 miliardë lekë të ardhura, përkundërt shpenzimeve të përgjithshme prej 491.897 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 416.852 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 74.993 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 31.3% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 304.758 miliardë lekë (ose rreth 94% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 23.102 miliardë lekë (ose rreth 90% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 97.396 miliardë lekë (ose rreth 99% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jokatimore në nivelin 25.267 miliardë lekë (ose rreth 111% e planit për periudhën Janar-Dhjetor 2019).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 416.852 miliardë lekë, 76.962 miliardë lekë (18.5% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 35.143 miliardë



lekë (8.5%) për shpenzime interesi, 47.215 miliardë leke (11.3%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.421 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 173.357 miliardë lekë (41.6%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 56.227 miliardë lekë (13.5%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 24.257 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 96% (shpenzime personeli), 88% (shpenzime për interesat), 99% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 99% (subvencione), 100% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 102% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 98% (shpenzimet e tjera) përkundërt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 94%, ndërsa financimi i huaj është 76% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2019 ishin rreth 460.349 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 426.271 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 25.267 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat gjatë muajit Dhjetor 2019 (mld Lekë)
Revenues during December 2019 (in billion ALL)

Burimi (Source)	Dhjetor '19 December '19	Dhjetor '18 December '18	Ndrysh(%) Chang (%)
TVSH (VAT)	12.20	12.62	-3.37
Taksa doganore (Custom Tax)	0.59	0.58	2.25
Akcizat (Excise)	4.28	4.18	2.33
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	3.82	4.28	-10.54
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	2.76	2.70	2.19
Taksat nacionale (National Tax)	3.97	3.05	-2.41

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Dhjetor – 2019

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: December – 2019

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej -31.5 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, u financua kryesisht nga huamarrja e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe nga huaja afatgjatë e huaj.

Për muajin Dhjetor 2019, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 39.220 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 59.646 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Dhjetor 2019, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 31.8 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 40.6 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 19.0 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month	
	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	2014	2015	2016	2017	2018		2019
Janar	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.7	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	January
Shkurt	2.4	1.1	0.5	0.8	0.6	1.9	1.0	1.0	1.0	1.1	1.9	2.3	0.2	2.2	2.1	1.7	February
Mars	0.4	0.5	0.4	0.3	-0.3	1.4	0.8	0.8	0.9	0.6	2.2	2.2	0.3	2.1	2.0	1.1	March
Prill	-0.5	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	0.9	0.5	0.5	0.5	0.4	1.7	2.3	0.3	1.9	2.1	1.4	April
Maj	-1.6	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	0.2	0.2	0.1	0.2	0.1	1.6	1.8	0.7	2.0	2.1	1.5	May
Qershor	-1.1	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	0.1	0.04	0.0	0.1	0.1	1.5	1.4	1.2	2.2	2.4	1.3	June
Korrik	-0.7	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	0.1	0.15	0.0	0.1	0.0	1.8	1.3	1.9	2.0	2.3	1.5	July
Gusht	0.8	0.9	0.4	0.4	0.3	0.1	0.17	0.1	0.1	0.1	2.0	1.9	2.0	1.6	2.2	1.5	August
Shtator	0.6	0.4	0.4	0.2	0.1	0.2	0.17	0.1	0.1	0.1	1.5	2.2	1.8	1.6	2.1	1.3	September
Tetor	0.0	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	0.1	0.13	0.1	0.1	0.0	1.4	2.1	1.5	1.9	1.9	1.3	October
Nëntor	-0.3	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	0.1	0.12	0.1	0.1	0.0	1.7	2.1	1.9	1.7	1.8	1.4	November
Dhjetor	0.6	0.9	1.0	1.1	0.8	0.17	0.19	0.2	0.2	0.1	0.7	2.0	2.2	1.8	1.8	1.2	December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2 Kursi i këmbimit
Exchange rate

Monedha	2016	2017	2018	2019												Currency	
				Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
				January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December		
<i>Mesatarja e periudhës</i>																	<i>Average of period</i>
USD	128.29	112.56	108.43	108.92	109.73	110.53	110.57	109.96	108.02	108.62	108.98	110.44	111.44	111.06	109.94		USD
EURO	135.27	133.25	123.45	124.39	124.56	124.99	124.34	122.99	122.00	121.95	121.26	121.61	123.11	122.80	122.17		EURO
<i>Fundi i periudhës</i>																	<i>In the end of period</i>
USD	128.17	111.10	107.82	108.58	110.51	111.67	110.09	109.97	107.69	109.07	110.59	111.70	110.44	111.34	108.64		USD
EURO	135.23	132.95	123.42	124.64	125.92	125.34	123.38	122.63	122.65	121.64	122.12	122.11	123.25	122.52	121.77		EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)
Annual Interest Rates (in ALL)

	2016	2017	2018	2019												In percent	
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November	Dhjetor December		
Në përqindje																	
Norma e depozitave																	Deposits rates
12-M	0.78	0.80	0.75	0.73	0.68	0.57	0.48	0.43	0.41	0.40	0.36	0.45	0.44	0.53	0.43		12-M
6-M	0.78	0.56	0.56	0.45	0.45	0.56	0.52	0.42	0.37	0.26	0.23	0.29	0.35	0.58	0.41		6-M
3-M	0.27	0.29	0.30	0.24	0.25	0.31	0.18	0.19	0.16	0.20	0.23	0.18	0.43	0.13	0.17		3-M
1-M	0.87	0.82	0.62	0.65	0.71	0.55	0.62	0.53	0.80	0.73	0.44	0.76	0.73	0.65	0.72		1-M
Norma e huasë																	Lending rates
12-M	4.54	6.79	6.34	6.76	5.89	5.89	6.23	6.55	5.39	6.25	5.73	6.75	6.62	6.43	6.82		12-M
6-M	7.01	8.12	8.16	7.63	7.50	7.69	6.87	9.67	6.70	6.31	7.69	7.00	5.94	7.02	6.34		6-M
Norma e letrave me vlerë																	Securities rates
Bono thesari 1/																	Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-		3-M
6-M	2.00	-	-	-	1.07	-	0.85	0.96	-	-	1.48	-	-	-	-		6-M
12-M	2.92	2.63	1.43	1.33	1.25	1.14	1.11	1.29	1.57	1.81	2.05	2.26	2.07	1.85	1.69		12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2019

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I												ITEMS
	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November	Dhjetor December	
TOTALI TË ARDHURAVE	34,675	68,862	108,222	149,290	188,464	226,116	265,798	305,929	343,859	383,403	421,129	460,349	TOTAL REVENUE
I. Të ardhura nga ndihmat	387	598	793	1,147	1,355	2,036	2,550	2,754	3,293	3,574	5,037	8,811	Grants
II. Të ardhura tatimore	33,030	64,590	101,552	140,451	176,918	212,212	249,804	288,463	323,399	361,022	394,410	426,271	Tax Revenue
II.1 Nga Tatimet dhe Doganat	22,638	44,928	72,773	97,755	124,713	150,364	176,925	205,798	231,377	257,584	282,268	304,758	From tax offices and customs
1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,971	21,550	32,380	43,518	54,961	65,913	78,471	90,539	100,728	113,383	124,709	132,412	V.A.T
2 Tatimi mbi Fitimin	1,613	4,049	11,651	15,272	17,696	20,444	22,544	24,587	27,173	29,684	32,745	36,575	Profit Tax
3 Akcizat	2,900	6,025	9,863	13,230	16,982	21,254	26,057	31,103	34,891	38,848	42,462	46,742	Excise Tax
4 Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,677	6,593	9,376	12,651	18,440	22,129	26,033	31,653	37,392	40,485	43,364	46,124	Personal Income Tax
5 Taksa Nacionale dhe të tjera	3,068	5,871	8,092	11,118	14,076	17,508	20,074	23,589	26,389	29,829	33,101	36,423	National Taxes and others
6 Taksa Doganore	410	840	1,411	1,966	2,558	3,117	3,747	4,326	4,804	5,354	5,888	6,482	Customs Duties
II.2 Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,353	3,173	4,909	9,627	11,348	13,458	15,180	17,255	18,998	20,785	21,829	23,102	Revenues from Local Gov.
1 Taksë mbi Pasurimin (ndërtesat)	221	431	817	2,279	2,665	3,123	3,470	3,820	4,194	4,548	4,827	5,208	Property Tax
2 Taksë mbi Biznesin e vogël	1	5	27	252	282	301	311	321	328	339	345	355	Small Business Tax
3 Taksa Lokale	1,131	2,737	4,066	7,096	8,401	10,034	11,399	13,114	14,477	15,899	16,656	17,539	Local Taxes
II.3 Të ardh nga fondet speciale	9,038	16,488	23,870	33,069	40,856	48,389	57,699	65,409	73,023	82,652	90,313	98,411	Social ins. contributions
1 Sigurimi Shoqëror	7,711	14,067	20,421	28,194	34,918	41,410	49,329	55,984	62,543	70,699	77,268	84,267	Social Insurance
2 Sigurimi Shëndetsor	1,271	2,213	3,167	4,454	5,456	6,424	7,731	8,721	9,703	11,083	12,107	13,129	Health insurance
III. Të ardhura Jotatimore	1,258	3,674	5,876	7,692	10,191	11,867	13,444	14,713	17,167	18,807	21,682	25,267	Nontax Revenue
1 Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			576	576	576	576	576	576	576	576	576	576	Profit transfer from BOA
2 Të ardhura nga Inst.Buxhetore	712	2,622	3,842	5,091	6,823	7,867	8,894	9,638	11,522	12,501	14,093	16,624	Income of budgetary institutions
TOTALI I SHPENZIMEVE	32,445	67,578	104,591	146,268	188,063	229,569	271,977	309,505	347,181	390,037	432,257	491,897	TOTAL EXPENDITURE
I. Shpenzime Korrente	28,971	61,789	95,344	129,973	165,834	200,108	237,554	271,250	304,451	341,860	376,214	416,852	Current Expenditures
I.1 Personell	5,949	12,034	18,305	24,484	31,065	37,690	44,415	50,890	57,241	63,723	70,128	76,962	Personnel expenditures
1 Paga	5,100	10,315	15,679	20,991	26,629	32,320	38,008	43,477	48,918	54,437	59,860	65,636	Wages
2 Kontributi për Sigurime Shoqërore	844	1,693	2,570	3,419	4,337	5,246	6,141	7,013	7,881	8,784	9,689	10,579	Social insurance contributions
I.2 Interesat	4,047	6,750	9,525	12,029	14,126	16,418	20,429	22,777	25,394	29,882	33,294	35,143	Interest
1 Të Brendshme	2,846	4,922	6,977	8,836	10,442	12,214	15,053	16,789	18,569	20,277	21,451	22,838	Domestic
2 Të Huaja	1,200	1,828	2,547	3,193	3,685	4,204	5,377	5,988	6,825	9,605	11,843	12,305	Foreign
I.3 Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,487	5,478	9,028	13,835	18,123	21,602	25,464	28,576	32,009	36,145	40,100	47,215	Operational & Maintenance
I.4 Subveçionet	74	203	359	430	489	546	601	682	787	986	1,238	1,421	Subsidies
I.5 Shpenzime për fonde speciale	12,387	25,873	40,017	53,663	68,063	82,876	97,840	113,440	128,234	143,118	157,056	175,628	Social insurance outlays
1 Sigurime Shoqërore	9,547	19,193	29,265	39,652	50,440	61,496	72,807	84,780	95,896	106,729	116,918	131,238	Social insurance
2 Sigurime Shëndetsore	2,376	5,890	9,963	13,097	16,512	20,102	23,571	27,198	30,676	34,432	38,029	42,118	Health insurance
I.6 Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,701	8,097	12,669	17,966	24,071	29,158	34,816	38,463	42,432	47,546	51,790	56,227	Local budget expenditure
I.7 Shpenzime të tjera	1,327	3,354	5,441	7,566	9,896	11,818	13,988	16,422	18,353	20,459	22,608	24,257	Other expenditures
1 Pagesa e Papunesisë	33	76	130	180	225	272	313	352	389	425	464	505	Unemployment insurance benefits
I.8 Transferime Kapitale				35	37	37	37	53	53	53	53	53	
II Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Reserve fund/contingency
III Shpenzime Kapitale	3,474	5,782	9,241	16,253	22,198	29,424	34,385	38,201	42,677	48,124	55,990	74,993	Capital expenditures
1 Financimi Brendshëm	2,583	3,237	6,027	11,250	15,950	21,125	24,118	26,852	29,211	32,829	37,071	50,641	Domestically financed
2 Financimi Huaj	886	2,496	3,145	4,847	5,949	7,909	9,784	10,845	12,939	14,638	18,196	23,462	Foreign financed
IV Detyrimet e papambetuar													Arrears
V. DEFICITI	2,230	1,284	3,630	3,023	400	-3,453	-6,177	-3,575	-3,322	-6,634	-11,128	-31,549	CASH BALANCE
V.1 FINANCIMI DEFICITIT	-2,230	-1,284	-3,630	-3,023	-400	3,453	6,177	3,575	3,322	6,634	11,128	31,549	CASH BALANCE FINANCING
V.2 Brendshëm	-1,502	-2,473	-3,348	-1,828	4,534	9,840	15,124	13,045	13,025	17,863	20,997	40,932	Domestic
1 Të ardhura nga privatizimi	29	34	47	67	76	79	100	102	152	156	196	242	Privatization receipts
2 Hua-marrje e brendshme	-5,900	-7,329	-2,600	799	2,733	5,226	7,060	6,638	10,223	15,419	16,300	17,846	Domestic new borrowing (net)
3 Të tjera	4,369	4,823	-795	961	1,726	4,536	7,964	6,305	2,649	2,288	4,500	22,844	Others
V.3 I huaj	-728	-1,189	-283	-4,850	-4,935	-6,387	-8,947	-9,469	-9,703	-11,229	-9,869	-9,383	Foreign
1 Hua afatgjatë(e marrë)	1,403	2,488	2,919	4,268	6,385	8,338	9,467	10,025	11,579	12,995	16,837	20,493	Long-term foreign borrowing (gross)
Nga e cila nënhua	222	291	447	491	979	1,138	1,556	1,632	1,838	2,323	2,484	2,535	Subsidiary Loan
2 Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-804	-445	-250	-206	-982	-1,650	-1,414	-1,120	-1,013	-657	-1,299	-1,729	Chang. of stat. Account
3 Ripagesat	-1,327	-2,254	-4,352	-10,313	-11,737	-14,475	-18,400	-20,018	-21,912	-25,210	-27,050	-29,791	Repayments
4 Mbështetje Buxhetore	-	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,643	1,643	1,643	1,643	1,643	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

Tab - 5

Tabela e investimeve 2019

Table of investments 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	December	
Financim i brendshëm	- 1,502	- 2,473	- 3,348	1,828	4,534	9,840	15,124	13,045	13,025	17,863	20,997	40,932	Domestic financing
Në %	67.4	192.59	92.2	-60.46	-1133.56	284.95	244.83	364.84	83.10	88.65	82.35	129.74	In %
Financim i huaj	- 728	1,189	- 283	- 4,850	- 4,935	-6,387	- 8,947	- 9,469	2,649	2,288	4,500	- 9,383	Foreign financing
Në %	32.6	-92.59	7.8	160.46	1233.56	-184.95	-144.83	-264.84	16.90	11.35	17.65	-29.74	In %
Totali	-2,230	-1,284	-3,630	-3,023	-400	3,453	6,177	3,575	15,674	20,150	25,497	31,549	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

TË ARDHURAT DOGANORE 2019
CUSTOMS REVENUES 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

